



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 442/ 2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala, kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Drenas, paraqitur kundër Iniciativës Qytetare për Drenasin (IQD) për shkak të parregullsive gjatë ditës së zgjedhjeve, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

**V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuara ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Drenas.

**Arsyetim**

PZAP-i , më datën 03.11.2013, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik PDK me të cilën pretendohet se afër vendvotimit në Sankofc të Drenasit rreth orës 09:00 përfaqësues të IQD-së Abdyl Krasniqi dhe Haradin Bala kanë provokuar qytetarët dhe vëzhguesit e PDK-së me ç`rast ka ardhur deri te incidenti

Lidhur me këtë çështje PZAP- i informoi policinë e Kosovës por nuk mori përgjigjen e kërkuar nga ta.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: *“Mund te apelothen vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

Pretendimet ankimore nga ana e PDK-se se në fshatin Sankofc të komunës se Drenasit ka pasur incidente, PZAP-i konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar nga shkakut se nga veprimet e ndërmarra nga PZAP-i në drejtim të vërtetësisë së shkeljes së pretenduar si dhe nga mungesa e ndonjë informacioni nga policia e Kosovës PZAP-i konstaton se me këtë rast nuk është arritur që të vërtetohen pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë. Andaj PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr. 442/2013 më datën 07.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Hasan Shala**



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.